


Në kuadër të krizës sanitare për shkak të COVID19, të gjitha strukturat tona të pritjes së fëmijëve zbatojnë masat dhe rekomandimet e marra nga instancat federale, kantonale dhe komunale. Është detyra dhe përgjegjësia jonë, si institucione publike, të kontribuojmë në luftën kundra përhapjes së epidemisë, në solidaritet me të gjithë popullin zvicerian .

Ne jemi të lumtur të mund të presim fëmijët tuaj pranë qendrave tona të pritjes së fëmijëve (EVE), por gjithashtu duhet ti nënshtrohemi udhëzimeve sanitare strikte të cilat kanë ndryshuar praktikatat tona të zakonshme të pritjes së fëmijëve dhe kontaktit me prindërit.

Ne ju falenderojmë paraprakisht për respektimin e këtyre udhëzimeve në mënyrë që përditshmëria në komunitet të vijojë më së miri në këto kushte të jashtëzakonshme.

Shërbimi angazhohet tju informojë në kohën e duhur për ndryshimin e masave dhe udhëzimeve sanitare.

SI TË MBROHEMI



Ruajtja e një distance prej 2m me të rriturit dhe mos shtrëngoni duart.

Mbajtja e një maske higjienike të detyrueshme për të gjithë të rriturit dhe fëmijët mbi 12 vjeç që hyjnë në strukturat e pritjes.

Të rriturit duhet të dezinfektojnë duart me xhel hidro-alkolik kur të hyjnë në strukturën e pritjes. Fëmijët duhet të lajnë duart kur të hyjnë në sallën e pritjes.

MBËRRITJA DHE LARGIMI

Oraret e mbërritjes dhe largimit mbeten të pandryshuar.

Për qendrat EVE Monthoux, Champs Fréchets, Parc dhe Vergers :

Mbërritja përpara orës 9:15 në mëngjes dhe largimi duke filluar nga ora 16:15 në fund të ditës.

Për qendrën EVE Cité :

Pritja e mëngjesit, mbërritja përpara orës 9:00 edhe largimi duke filluar nga ora 11:00.

Pritja e pasdites, mbërritja përpara orës 15 :00 dhe largimi duke filluar nga ora 16 :30.

Këto orare janë të ndryshueshme për fëmijët në fazë adaptimi.

Takimet e prindërve

Takimet duhet të organizohen paraprakisht në mënyrë që të mund të parashikohet një sallë takimi e përshtatshme për të pritur personat e thërritur.

Gjatë takimeve duhet të kihet parasysh këto masa parandaluese, si :

- ✓ Distancimi fizik prej 2m
- ✓ Larja ose dinfektimi i duarve në hyrje dhe në dalje
- ✓ Mbajtja e detyrueshme e maskës

SENDET PERSONALE

Gjatë ditës, sendet personale të fëmijëve mund të jenë vetëm arushët ose kukullat.

Nëse është e mundur, këshillohet të mos lini në hapësirat e qendrës karrocet e fëmijëve (bicikleta, trotineta (monopatina), ...) në mënyrë të evitohet shpërndarja e virusit në hapsirat e caktuara për këtë qëllim.

SHËNDETI

Sëmundjet dhe kushtet mjekësore që kërkojnë largimin e një fëmije nga qendra EVE janë të përshkruara në broshurën « Shëndeti i fëmijës » që ju është vënë në dispozicion. Ju lutemi ti referoheni për çdo rast.

Këto udhëzime kanë ndryshuar me situatën e krijuar nga COVID19 dhe mund të jenë tejet kufizuese. Ju do të njoftoheni shkurtimisht rreth ndryshimeve që janë ndërmarrë.

Prindërit dhe të rriturit që paraqesin simptoma ose kanë qënë në kontakt më një person bartës të virusit, janë të lutur të respektojnë masat e izolimit dhe/ose karantinës për të mos përhapur virusin. E njëjta gjë vlen edhe nëse keni qëndruar në një zonë me rrezik (cf. lista e publikuar nga OFSP). **Nëse jeni objekt i këtyre udhëzimeve, ju nuk mund të shoqëroni ose prisni fëmijën tuaj në qendrën e pritjes.**

Drejtoria ka të drejtë të aplikojë masat rregullatore për cilindo që nuk respekton kuadrin ligjor në fuqi.

Drejtoria dhe strukturat e pritjes, ashtu si edhe ekipet edukative mbeten në dispozicionin tuaj për tju përgjigjur pyetjeve dhe ju urojnë një fillim të mbarë.